

V. KONKLUZIONE

Në bazë të të gjitha elementëve që kishim në dispozicion dhe pas analizave të kryera në laboratoret e QURML dhe të Shkollës së Shkencave Kriminologjike (ESC) mund t'i nxerrim këto konkluzione:

1. Analizat ADN të ndërmarra mbi objektet që kanë qenë në kontakt me viktiminë në një moment të afërt me vdekjen (brisk roje, stilolaps i lidhur me një lidhëse këpucash dhe një pjesë metali), nuk kanë treguar profil ADN tjetër përvèç se atij të z.Astrit DEHARIT
2. Ekzaminimi i fotografive të objekteve ka treguar se nuk është nxjerr asnjë gjurmë të gishtave që ka mundur të përdoret. Gjithashtu ekzaminimi i objekteve fizike (shishja e plastikës #5, brisk roje #13, stilolapsi i lidhur për lidhësen e këpucës #14 dhe pjesa e metaltë #17) kanë treguar se tentativa të reja për të gjetur gjurmë të gishtave në këto objekte nuk ishin relevante.
3. Analizat toksikologjike plotësuese të gjakut periferik të Astrit DEHARIT kanë treguar praninë e një metabolitet të kafeinës dhe mosprani të etanolit.
4. Nuk rekomandojmë analiza plotësuese në fushën e gjenetikës, të daktiloskopisë dhe të toksikologjisë.
5. Trupi i të ndjerit përbën provën më të rëndësishme, por edhe provën e cila më së paku është përdorur. E vtmja mënyrë për të gjetur prova të mundshme do t'ishte të riekzaminohet trupi pas një exhumimi (zhvarrosje). Megjithatë, duke pasur parasysh sa kohë ka kaluar dhe sa e rëndë është kjo masë, nuk e rekomandojnë.

Materiali i cili është vënë në dispozicion të QURML do të ruhet duke pritur udhëzime të reja nga Prokuroria.

Duke shpresuar se i jemi përgjigjur kërkesës suaj dhe duke mbetur në dispozicionni tuaj për informata plotësuese, ju përshëndesim i nderuar prokuror.

Prof.Dre.med. S. GRABHERR
Specialiste FHM e mjekësisë ligjore
Drejtoreshë e QURML

Dr.Sc.V. CASTELLA, PD, MER
Specialist i gjenetikës forenzike SSML
QURML

Prof.C. CHAMPOD
Drejtore i Shkollës së Shkencave Kriminologjike
Universiteti i Lozanës

M.A. ANTHONIOZ
Bashkëpunëtor shkencor
Shkolla e Shkencave Kriminologjike
Univerziteti i Lozanës